



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 156, datë 30.07.2018

PËR

**MIRATIMIN E NJË SHTESE NË RREGULLOREN NR. 36, DATË 21.03.2012 “PËR
KRIJIMIN, LLOGARITJEN, FINANCIMIN, ADMINISTRIMIN E FONDIT TË
KOMPENSIMIT DHE KRYERJEN E PAGESAVE TË DËMEVE”**

Në bazë të nenit 127 të Kodit të Procedurave Administrative, nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, neni 42, pika 8 e Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

KONSTATOI SE:

Në vijim të vendimit të Bordit nr. 217, datë 28.12.2017 “Mbi fondin e kompensimit të vitit 2018” dhe për zbatim të kërkesave të Rezolutës së Kuvendit “Për vlerësimin e veprimtarisë së AMF-së për vitin 2017”, ka nevojë për ndërhyrje në Rregulloren nr. 36, datë 21.03.2012 “Për krijimin, llogaritjen, financimin, administrimin e fondit të kompensimit dhe kryerjen e pagesave të dëmeve”.

Në vendimin e Bordit nr. 217, datë 28.12.2017, është përcaktuar qartë se:

“Të urdhërojnë Byronë Shqiptare të Sigurimit për ndjekjen e procedurës të shlyerjes menjëherë për pagesat e praktikave të dëmeve objekt i Fondit të Kompensimit për të cilat ka përfunduar procesi i trajtimit...”

Referuar nenit 29, të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, si dhe Rregullores nr. 36, datë 21.03.2012 “Për krijimin, llogaritjen, financimin, administrimin e fondit të kompensimit dhe kryerjen e pagesave të dëmeve”, Byroja delegon për trajtim dhe pagesë dëmet e fondit të kompensimit te shoqëritë e sigurimit.

Pra është Byroja e cila duhet të dërgojë pranë shoqërive të sigurimit kopje të praktikës së përfunduar e shoqëruar me autorizimin përkatës.

Në rast të mosplotësimit të këtij detyrimi nga BSHS, me qëllim mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, Autoriteti do të marrë kompetencat e BSHS-së.

Përsa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e një shtese në Rregulloren nr. 36, datë 21.03.2012 “Për krijimin, llogaritjen, financimin, administrimin e fondit të kompensimit dhe kryerjen e pagesave të dëmeve” si vijon:

Në nenin 6, pas pikës 1, shtohet pika 1.1. me këtë përmbajtje:

“1.1. Nëqoftëse Byroja Shqiptare e Sigurimit nuk bën shpërndarjen e praktikave të dëmeve të fondit të kompensimit tek shoqëritë e sigurimit anëtarë të saj sipas vlerave respektive të detyrimit të tyre, shpërndarja për pagesë tek shoqëritë e sigurimit, do të bëhet nga vetë Autoriteti.

Byroja Shqiptare e Sigurimit brenda 7 ditëve nga data e marrjes dijeni nga Autoriteti të shpërndarjes së praktikës do të vijojë me dërgimin e autorizimit dhe kopjen e praktikës tek shoqëria e sigurimit e caktuar nga Autoriteti.

Shoqëria e sigurimit ndjek procedurën e rimbursimit sipas parashikimeve të kësaj rregulloreje.”

2. Ngarkohet Drejtoria e Zbatueshmërisë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin KOÇI